



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2019:276460

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05753847

KA.nr. 240/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Platforma Akademia ShPK me NUI 810866519 dhe seli në lagjen Arbëria, Veranda C2, H3, Nr. 39, në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrative, jashtë seancës më 30 maj 2024 mori këtë:

AKTVENDIM

Pezullohet procedura e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit Platforma Akademia ShPK me NUI 810866519, kundër të paditurit Organit Shqyrtues të Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 561/19 i datës 23.10.2019 së të paditurit.

ARSYETIM

Paditësi më datë 26.11.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative ka ushtruar padi, kundër të Paditurit, me të cilën i ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 561/19 i datës 23.10.2019 së të paditurit.

Megjithatë Paditësi me anë të parashtresës të datës 23.05.2024 e ka tërhequr padinë.

Duke marr për bazë se sipas nenit 31 para.1 të LKA-së paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi dhe se në këtë rast gjykata e pezullon, gjykata vendosi si në

dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata sheh të arsyeshme të sqaroj se, në konfliktit administrativ, sipas nenit të cituar më lartë, nuk kërkohet pëlqimi i të Paditurit për tërheqjen e padisë, rrjedhimisht nuk e mori mendimin e të Paditurit.

Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.240/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.